2.1.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ligjore për ushtrimin e aktivitetit (furnizimin/tregëtimin e mallrave) objekt prokurimi.

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros së ofertuesit për 3 (tre) vitet e fundit financiare, (2017, 2018 dhe 2019). Xhiro mesatare e tre viteve të fundit, nuk duhet të jetë më e ulët se 40% e vlerës së përlllogaritur të lotit/loteve që konkuron.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e furnizimeve të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së përlllogaritur të lotit/loteve që konkuron.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

a) Kur kontratat janë realizuar me ente publike, duhet të paraqitet kontrata dhe fatura/at tatimore përkatëse, ku të jenë shënuar qartësisht datat, shumat dhe sasi të dhe nënshkrimet përkatëse, e shoqëruar me vërtetim realizim kontrate i lëshuar nga enti publik.

dhe/ose

b) Kur kontratat janë realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vetëm faturat tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar qartësisht datat, shumat dhe sasi të dhe nënshkrimet përkatëse.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambient në funksion të realizimit të kontratës, të përshtatshëm për tregtimin/magazinimin e artikujve objekt prokurimi, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Për këtë kriter, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton pronësinë/huapërdorjen/qiramarrjen si më poshtë:

Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

Dokumentet e tenderit - Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me objekt “Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19”

- Kontratë huaje.
- *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
- Kontratë qiraje.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- Kontratë huaje.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,

e) Certifikate për transport mallrash, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të operojnë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë duhet të paraqesin **vetdeklarim**, ku të deklarojnë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Shënim :

Në qoftë se një OE ekonomik konkurren për më shumë se një lot, duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat lidhur me kapacitetet teknike dhe financiare në përputhje me vlerën limit të lotit/lotëve për të cilët konkurren.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Për Loti nr. II, me objekt “Blerje materiale mbrojtëse për mbështetjen e personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 2;*
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;*
- c. Deklaraten mbi permbushjen e specifikimeve teknike sipas Shtojcës 5;*
- d. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

Dokumentet e tenderit - Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me objekt "Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19"

- e. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 8/1:*
- f. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ligjore për ushtrimin e aktivitetit (furnizimin/tregëtimin e mallrave) objekt prokurimi.

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros së ofertuesit për 3 (tre) vitet e fundit financiare, (2017, 2018 dhe 2019). Xhiro mesatare e tre viteve të fundit, nuk duhet të jetë më e ulët se 40% e vlerës së përlllogaritur të lotit/loteve që konkurron.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e furnizimeve të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së përlllogaritur të lotit/loteve që konkurron.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

a) Kur kontratat janë realizuar me ente publike, duhet të paraqitet kontrata dhe fatura/at tatimore përkatëse, ku të jenë shënuar qartësisht datat, shumat dhe sasi të dhe nënshkrimet përkatëse, e shoqëruar me vërtetim realizim kontrate i lëshuar nga enti publik.

dhe/ose

b) Kur kontratat janë realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vetëm faturat tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar qartësisht datat, shumat dhe sasi të dhe nënshkrimet përkatëse.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi, të cilin duhet ta ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

➤ *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose

- kontrata e shitblerjes; ose

- kontrata e dhurimit; ose

- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ *Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:*

- Kontratë huaje.

➤ *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*

- Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit.

Dokumentet e tenderit - Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me objekt "Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19"

- c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,
- e) Certificate për transport mallrash, për mjetet me kapacitet transportues mbi 1500 kg.

Shënim :

Në qoftë se një OE ekonomik konkurren për më shumë se një lot, duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat lidhur me kapacitetet teknike dhe financiare në përputhje me vlerën limit të lotit/lotëve për të cilët konkurren.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shenim:

Në zbatim të ndryshimeve të fundit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ku parashikohet ndalimi i dhënies së kontratave publike, operatorëve ekonomikë që janë ose kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për një listë të veprave penale, tashmë jo vetëm për operatorin ekonomik si subjekt juridik, por edhe kur individët, përfaqësues të subjektit kanë apo kanë patur një dënim të tillë dhe referuar njoftimit të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, datë 1.2.2019, autoriteti kontraktor ka detyrimin që të bëjë verifikimet për personat e deklaruar nga OE në shtojcën 5 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”. Në kushtet kur me të dhënat e paraqitura në shtojcën nr. 5, është e pamundur të bëhen verifikimet e duhura nga Regjistri Elektronik i Gjendjes Gjyqësore, lutemi nga ana juaj dërgimin e të dhënave të plota për të mundësuar zbatimin e detyrimeve të sipërcituara.

Të dhënat e kërkuara për çdo person të deklaruar janë si më poshtë:

Mbiemri, emri	
Atësia / amësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (kopje)	

Shënim: të dhënat e kërkuara janë sipas formatit të aneksit 1, bashkëlidhur V.K.M. nr. 824, datë 06.12.2006 “Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin, në mënyrë elektronike të gjendjes gjyqësore si dhe formularit të vetë deklaramit”, i ndryshuar.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

- **Për Lotin nr. I, me objekt “Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë për përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19”, specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi janë si më poshtë:**

I - ORIZ - SSH 1738-87

1 - TREGUESIT SHQISORË

Pamja e jashtme:

- Kokrra të shëndosha kokërrgjata, të pastra të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit. Pa shenja myku ose prishje.

Ngjyra:

- E bardhë, lejohen kokrra me nuancë me ngjyrë të kuqe e të verdhë.

Era dhe shija:

- Karakteristike e orizit të shëndoshë. Pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.

2 - TREGUESIT FIZIKO-KIMIK

- Lagështia jo më shumë se 15%.
- Lëndë të huaja jo më shumë se 0,4%.
- Kokrra jeshile të pazhvilluara jo më shumë se 0,5%.
- Kokrra të thyera më të vogla se gjysma, jo më shumë se 12%.
- Kokrra të kuqe jo më shumë se 15%.
- Kokrra të verdha jo më shumë se 4%
- Lëndë minerale, nuk lejohen.
- Dëmtues hambari, nuk lejohen.
- Kokrra të prishura nga vetëngrohja, të mbira, të mykura, të nxira dhe të karbonizuara, nuk lejohen.
- Kokrra të pazhveshura, nuk lejohen.

3 - AMBALAZHIMI

Të jetë i paketuar në qese polietileni me masë 1kg dhe të paketuara në kuti kartoni me masë 10 deri 12 kg/kuti. Etiketimi i produktit do të kryhet në zbatim të SSH 1738-87, nga ku, mbi çdo paketim orizi të jetë shënuar:

- emri i produktit;
- sasia në kg
- vendi i origjinës;
- data e prodhimit të produktit;
- afati i skadencës, i cili të jetë jo më pak se 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës dhe të jetë e shënuar në ç’do qese orizi;
- emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
 - etiketa (bashkëngjitur) duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, të jetë e dallueshme, e

lexueshme dhe e kuptueshme dhe në të të jenë shënuar:

- lista e përbërësve;
- sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve (nëse ka);
- çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit.

4 - MOSTRA

- Dy qese nga një kilogram që do të merren rastësisht, do të shoqërohet me fletë analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analizat të përputhen me emërtimin e orizit të pasqyruar në ambalazh dhe një vetë deklaram të subjektit mbi origjinën e produktit, e vulosur nga vetë subjekti.
- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë (analizat) me treguesit shqisore dhe fiziko-kimikë, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë, është kusht skualifikues.

II - VAJ USHQIMOR LULEDIELLI - SSH 203-2002

1- KRITERET E CILËSISË

Pamja e jashtme:

- Lëng vajor i qartë pa depozitime në fund.

Ngjyra:

- E verdhë e lehtë.

Era dhe shija:

- Karakteristike e vajit të lulediellit, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.

Numri i peroksideve (mek O₂/kg):

- <10

Numri i aciditetit për Vaj i rafinuar:

- Aciditeti i shprehur oleik <0,2%

Kontaminuesit:

- Lagështia dhe lëndë fluturuese <0,2%
- Plumb (Pb) <0,1 mg/kg
- Arsenik (As) <0,1 mg/kg

2- TREGUESIT FIZIKO-KIMIKË

- Dendësia relative (20°C/ ujë në 20°C) 0,918% - 0,923%
- Treguesi i refraksionit 1.461 – 1.468
- Numri i sapunifikimit (mg KOH/g vaj)
- Treguesi i Jodit 118 – 141
- Lëndë të pasapunifikueshme ≤15 g/kg (<0.1)
- Treguesit e tjerë sipas SSH 203-2002

3- AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

- Vaj ushqimor i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike PET me vëllim 1 - 3 litra të mbyllur me tapë plastike me vidhëzim hermetik të kapsuluar me shirit PVC me stampën përkatëse dhe të futura në kuti kartoni/qese.
- Etiketimi i produktit do të kryhet në zbatim të Ligjit Nr.9863, datë 28.01.2008 "Për

ushqimin", nga ku, mbi çdo bidon do të vendoset etiketa në të cilën të shënohet:

- emri i produktit;
- lista e përbërësve;
- sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve;
- sasia në litra;
- çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit;
- emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
- vendi i origjinës;
- data e prodhimit të produktit;
- afati i skadencës, i cili të jetë jo më pak se 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës dhe të jetë i shënuar në ç' do shishe vaji;
- shmangia në vëllim $\pm 1\%$;
- standardi në fuqi.

Etiketa duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, të jetë e dallueshme, e lexueshme dhe e kuptueshme.

4- MOSTRA

- Prej dy mostra nga 1-3 litër vaj të rafinuar me shishe plastike PET transparente pa ngjyrë, e shoqëruar me raport analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analiza të përputhet me emërtimin e vajit sipas etiketës në shishe dhe një vetë deklaram të subjektit mbi origjinën e produktit, e vulosur nga vetë subjekti.
- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë (analizat) me treguesit shqisorë dhe fiziko-kimikë, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë, është kusht skualifikues.

III - KRIPË - SSH 1437-2005

1 - TREGUESIT SHQISORË

Lloji:

- Të jetë kripë ushqimore e bardhë, e përpunuar (e larë dhe e bluar) për përdorim në kuzhinë, e jodizuar, cilësia e parë.

Pamja dhe ngjyra:

- Masë kokrrizore me ngjyrë të bardhë.

Era dhe shija:

- E kripur, pa erë dhe shije të huaj.

2 - TREGUESIT FIZIKO-KIMIKË

- Klorur natriumi në lëndën e thatë, në kufijtë $99 \pm 0.02\%$.
- Klorur magnezi në lëndën e thatë, jo më shumë se $0,23\%$.
- Sulfat magnezi në lëndën e thatë, jo më shumë se $0,25\%$.
- Sulfat kalciumi në lëndën e thatë, jo më shumë se $0,30\%$.
- Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në kufijtë $0.17 \pm 0,02\%$.

- Lagështia, jo më shumë se 1%.
- Imtësia në kufijtë 0,2 deri 2 mm.
- Jodi 40 ± 3 mg/kg kripë.

3 - AMBALAZHIMI

- Kripa e jodizuar të jetë e ambalazhuar në qese polietileni ushqimorë me masë 0.5 kg dhe të paketuara në koli 10-20 kg/koli.
- Etiketimi i produktit do të kryhet në zbatim të VKM-së Nr.1344, datë 10.10.2008 "*Përmirimitin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore*", nga ku mbi çdo qese polietileni 0,5 kg kripe të jetë shënuar:
 - emri i produktit;
 - lista e përbërësve;
 - sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve (nëse ka);
 - sasia neto;
 - çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit;
 - emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
 - vendi i origjinës;
 - data e prodhimit të produktit;
 - afati i skadencës, i cili të jetë jo më pak se 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës dhe të jetë e shënuar në ç' do qese të kripës.

4 - MOSTRA

- Dy qese polietileni nga 0.5 kg, shoqëruar me raport analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analiza të përputhet me emërtimin e kripës të pasqyruar në ambalazh dhe një vetë deklaram të subjektit mbi origjinën e produktit, e vulosur nga vetë subjekti.
- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë me treguesit shqisorë dhe fiziko-kimik, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë është kusht skualifikues.

IV - KONSERVA MISH VIÇI - SSH 1544-87

1- TREGUESIT SHQISORË

Lloji:

- Të jenë me mish viçi.

Shija dhe era:

- E këndshme, karakteristike e mishit të zier sipas lëndës së parë të prodhuar me shijen e piperit të zi dhe të dafinës, pa shije dhe erë të huaj.

Konsistenca e mishit:

- Të zierë normalisht të jetë elastike dhe të ruajë strukturën morfologjike të indit.

Ngjyra e lëngut:

- Karakteristikë e mishit të freskët, në rozë.

Pamja e jashtme e kutisë:

- E mbyllur hermetikisht pa fryrje, pa deformime mekanike, pa njolla oksidimi, pa

dëmtime të shtresës së llakut.

2- TREGUESIT FIZIKO-KIMIK DHE BAKTERIOLOGJIKË

- Sasia e mishit ndaj masës së konservës në përqindje jo me pak se 72%.
- Yndyra jo më shumë se 13%
- Kripa 1-2%
- Përmbajtja e kripërave të metaleve të rënda në mg/kg, jo më shumë se:
Kallaj 200 mg/kg
Plumb 2 mg/kg
Arsenik 1 mg/kg
- Ngarkesa mikrobike brenda kufijve të lejuar nga Ministria e Shëndetësisë.

3- AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

- Konservat e mishit të jenë të ambalazuara në kuti teneqeje, të pastra, të kallajisura ose të llakuara, në masë 0.25-0.5 kg dhe të paketuara në arka druri ose kartoni 10 deri 20 kg.
- Etiketimi i produktit do të kryhet në zbatim të VKM-së Nr.1344, datë 10.10.2008 "*Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore*", nga ku, mbi çdo kuti konserve vendoset ose stampohet etiketa ku janë të shënuara:
 - lloji i konservës;
 - lista e përbërësve;
 - sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve;
 - sasia neto;
 - çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit;
 - emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
 - vendi i origjinës;
 - data e prodhimit të produktit;
 - afati i s kadencës, i cili të jetë jo më pak se 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës dhe të jetë i shënuar në ç' do kuti konserve;
 - standardi në fuqi.
- Etiketa duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, të jetë e dallueshme, e lexueshme dhe e kuptueshme.

4 - MOSTRA

- Dy kuti metalike konservash nga 0.25-0.5 kg, shoqëruar me raport analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analizat të përputhen me emërtimin e konservave të pasqyruar në ambalazh dhe një vetë deklaram të subjektit mbi origjinën e produktit, e vulosur nga vetë subjekti.
- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë me treguesit shqisorë dhe fiziko-kimik, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë është kusht skualifikues.

1- TREGUESIT SHQISORË

Lloji: Makarona të thjeshta, të prodhuara nga brumë i përgatitur vetëm me miell gruri.

- Forma spaghetti me gjatësi 28cm-30cm, me trashësi 2 deri 2,4mm.

Pamja:

- Të jenë me formë të rregullt, të plota me sipërfaqe të lëmuar, lejohen përkulje dhe plasaritje të vogla. Mbas zierjes makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.

Ngjyra:

- E bardhë me nuancë ngjyrë të verdhë.

Era dhe shija:

- E mirë karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe çfarëdo erë dhe shije tjetër të huaj.

2- TREGUESIT FIZIKO-KIMIK

- Lagështia jo më shumë se 13%
- Aciditeti (i shprehur në acid sulfurik) jo më shumë se 0.16%
- Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 (dy) herë
- Insekte e dëmtues të tjerë nuk lejohen

3- AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

- Artikulli ushqimor "**Makarona**" të jetë i ambalazhuar në qese polietileni me masë 0,5-1kg dhe të paketuara në kuti kartoni me masë 10 deri 12 kg/kuti.
- Kutitë e kartonit duhet të jenë të pastra, pa lëndë të huaja, pa lagështi.
- Etiketimi i produktit do të kryhet në zbatim të Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 "*Për ushqimin*", nga ku, mbi çdo ambalazh të shënohet:
 - emri i produktit;
 - lista e përbërësve;
 - sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve;
 - sasia në kg;
 - çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit;
 - emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
 - vendi i origjinës;
 - data e prodhimit të produktit;
 - afati i skadencës, i cili të jetë jo më pak se 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës, i cili të jetë i shënuar në ç' do ambalazh të makaronave;
 - shmangia në vëllim $\pm 2\%$;
 - standardi në fuqi.

4-MOSTRA

- Prej dy mostra nga 0.5 kg makarona, e shoqëruar me raport analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analiza të përputhet me emërtimin e makaronave sipas ambalazhit të tyre dhe një vetë deklaram të subjektit mbi origjinën e

produktit, e vulosur nga vetë subjekti.

- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë (analizat) me treguesit shqisorë dhe fiziko-kimikë, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë, është kusht skualifikues.

VI - FASULE - SSH 1723-87

1- TREGUESIT SHQISORË

Pamja e jashtme:

- Kokrra të plota, të shëndosha, me formë e madhësi sipas llojit; (ovale, e rrumbullakët).

Ngjyra:

- E bardhë e shndritshme.

Era dhe shija:

- Pa erë myku ose çfarëdo erë tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

2- TREGUESIT FIZIKO-KIMIK

- Lagështia jo më shumë se 15%.
- Kokrra fasulesh të thyera jo më shumë se 13%.
- Përzierje kokrrash jo më shumë se 2.2%.
- Kokrra te verdha, të pazhvilluara normalisht e të rrudhosura nuk lejohen.
- Lëndë të huaja jo më shumë se 0.8%.
- Dëmtime mekanike, nuk lejohen.
- Infeksione ose demtime nga insektet nuk lejohen.

3- AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

- Artikulli "*Fasule*", të jetë i pakeluar në qese polietileni 1-5 kg.
- Qeset duhet të jenë të pastër pa lëndë të huaja, pa lagështi.
- Etiketimi i produktit do të kryhet në zbatim të Ligjit Nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për ushqimin*", nga ku, mbi çdo qese fasule të jetë shënuar:
 - emri i produktit;
 - sasia në kg;
 - vendi i origjinës;
 - data e prodhimit të produktit;
 - afati i skadencës, i cili të jetë jo më pak se 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës dhe të jetë e shënuar në ç'do qese fasule;
 - emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
- Etiketa (bashkëngjitur) duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, të jetë e dallueshme, e lexueshme dhe e kuptueshme dhe në të të jenë shënuar:
 - lista e përbërësve;
 - sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve (nëse ka);
 - çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit.

4- MOSTRA

- Dy qese nga një kilogram, do të shoqërohet me fletë analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analizat të përputhen me emërtimin e fasules të pasqyruar në ambalazh dhe një vetë deklarament të subjektit mbi origjinën e produktit, e vulosur nga vetë subjekti.
- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë (analizat) me treguesit shqisorë dhe fiziko-kimikë, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë, është kusht s kualifikues.

VII - SHEQER- SSH 1413-87

1 - TREGUESIT SHQISORË

Pamja e jashtme:

- Pluhur i përbërë nga kristale të imta. Pa copa sheqeri të ngjeshura ose lëndë të huaja. Të jetë i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.

Ngjyra:

- E bardhë dhe me shkëlqim.

Era dhe shija:

- Shija e ëmbël, pa shije dhe erë të huaja kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.

Tretshmëria:

- Tretet plotësisht në ujë. Tretësira është e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

2 - TREGUESIT FIZIKO-KIMIK

- Sheqer i pastër i llogaritur në lëndë absolutisht të thatë jo më pak se 99.6%.
- Lëndë reduktuese (sheqer invert) jo më shumë se 0.1%.
- Hiri jo më shumë se 0.07%.
- Lagështia jo më shumë se 0.16%.
- Përzierje hekuri me madhësi deri 0,3 mm, mg/l kg, jo më shumë se 3%.
- Ngjyra sipas njësive shtamore (llogaritur në lëndë absolutisht të thatë), jo më shumë se 1%.

3 - AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

- Artikulli "**Sheqer**", të jetë i paketuar me pako letre në masën 1kg.
- Paket duhet të jenë të pastra pa lëndë të huaja, pa lagështi.
- Etiketimi i produktit do të kryhet në zbatim të Ligjit Nr.9863, datë 28.01.2008 "*Për ushqimin*", nga ku, mbi çdo ambalazh të shënohet:
 - emri i produktit;
 - sasia në kg
 - vendi i origjinës;
 - data e prodhimit të produktit;
 - afati i skadencës, i cili të jetë jo më pak se 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës dhe të jetë e shënuar në ç' do paketim sheqeri;
 - emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
- Etiketa (bashkëngjitur) duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, të jetë e dallueshme, e

lexueshme dhe e kuptueshme dhe në të të jenë shënuar:

- lista e përbërësve;
- sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve (nëse ka);
- çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit.

4- MOSTRA

- Dy pako nga një kilogram, do të shoqërohet me fletë analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analizat të përputhen me emërtimin e sheqerit të pasqyruar në ambalazh dhe një vetë deklaram të subjektit mbi origjinën e produktit, e vulosur nga vetë subjekti.
- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë (analizat) me treguesit shqisorë dhe fiziko-kimikë, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë, është kusht s kualifikues.

VIII- DETERGJENT- SSH 1357-87

1- TREGUESIT SHQISORË

Pamja e jashtme:

- Masë e pluhurizuar imët.

Ngjyra:

- Rozë, e bardhë jeshile.

Aroma:

- Sipas esencës së përdorur.

Tretshmëria:

- E tretshme në ujë, plotësisht e dispergueshme.

2- TREGUESIT FIZIKO-KIMIKË

- Përmbajtja e lëndës tension-aktive 12% -14%.
- Tretshmëria në ujë, jo më pak se 95%.
- Përmbajtja e lagështisë, jo më shumë se 10%.
- Densiteti 0,4-0,5 gr/cm³.
- Aftësia shkumuese mbi 2 cm.
- Përmbajtja e joneve H⁺, ph 9-11.
- Përmbajtja e perboratit të natriumit 6-8%.

3- AMBALAZHIMI

- Artikulli "**Detergjent**", të jetë të jetë i pakeluar në qese plastike polietileni të qëndrueshme për transport, në masën 1- 3 kg.
- Mbi çdo ambalazh të shënohet në gjuhën shqipe:
- emri i produktit;
- lista e përbërësve;
- sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve;
- sasia në kg;
- çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit;
- emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
- vendi i origjinës;

Dokumentet e tenderit - Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me objekt "Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19"

- data e prodhimit të produktit;
- afati i skadencës, i cili të jetë jo më pak se 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës, i cili të jetë i shënuar në ç' do ambalazh të detergjentit;
- standardi në fuqi.

4- MOSTRA

- Prej dy mostra nga 1-3 kg të shoqërohen me fletë analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analizat të përputhen me emërtimin që ka lloji i pluhurit larës me dorë, të pasqyruar në ambalazh dhe një vetë deklaram të subjektit mbi origjinën e produktit, e vulosur nga vetë subjekti.
- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë (analizat) me treguesit shqisorë dhe fiziko-kimikë, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë, është kusht s kualifikues.

IX – SAPUN TUALETI - SSH 2162-88

1 - TREGUESIT SHQISORË

Pamja e jashtme:

- Masë homogjene jo ngjyritëse me formë e stampim të rregullt.

Konsistenca:

- Në prekje të jetë i fortë.

Ngjyra:

- Me ngjyrë të njëjtë karakteristike e lëndës së parë të përdorur.

Era:

- Karakteristike e sapunit, pa erën e yndyrave të prishura dhe pa çdo erë tjetër të huaj.

2 - TREGUESIT FIZIKO-KIMIK

- Vlera e PH të jetë 7 deri 10.
- Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 12 gr/cm³.
- Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95 %.
- Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se % cm

3 - AMBALAZHIMI

Të jetë i paketuar në qese plasmasi me peshë 100 deri 125 gr/sapuni me mbyllje hermetike, dhe qesja të përmbajë 1 deri në 10 sapunë secila të vendosura në kuti kartoni. Etiketimi i produktit të kryhet në zbatim të SSH 2166-88, nga ku, mbi çdo paketim sapun tualeti të jetë shënuar:

- emri i produktit, marka dhe barkodi;
- sasia në gr;
- vendi i origjinës;
- data e prodhimit të produktit;
- afati i skadencës, i cili të jetë jo më pak se 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës dhe të jetë e shënuar në çdo paketim;
- emri apo emërtimi i biznesit dhe adresa e prodhuesit, ambalazhuesit dhe/ose e tregtarit;
- etiketa (bashkëngjitur) duhet të shkruhet në gjuhën shqipe, të jetë e dallueshme, e lexueshme dhe e kuptueshme dhe në të të jenë shënuar:
 - lista e përbërësve;
 - sasia e përbërësve të veçantë ose e kategorive të përbërësve (nëse ka);
 - çdo kusht i veçantë i ruajtjes dhe/ose i përdorimit.

4 - MOSTRA

- Dy kallëpë sapuni që do të merren rastësisht, do të shoqërohet me fletë analizë (analiza) për të gjithë treguesit, nga laboratorë të licencuar, ku analizat të përputhen me emërtimin që ka lloji i sapunit të pasqyruar në ambalazh dhe një vetë deklaram të subjektit mbi origjinën e produktit, e vullosur nga vetë subjekti.
- Mospërputhja e mostrës nga pamja e jashtme me fletë analizë (analizat) me treguesit shqisorë dhe fiziko-kimikë, qoftë vetëm për një tregues më të ulët të cilësisë, është kusht skualifikues.

Shënim:

Në momentin e marrjes në dorëzim të artikujve ushqimorë, subjekti duhet të paraqesë fletë analizën/analizat për të gjithë treguesit e përcaktuar në këto specifikime teknike dhe certifikatën e origjinës së produkteve.

Dokumentet e tenderit - Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me objekt “Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19”

- **Për Lotin nr. II, me objekt “Blerje materiale mbrojtëse për mbështetjen e personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19”, specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi janë sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur DT.**

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

- Për Lotin nr. I, me objekt “*Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë për përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19*”, artikujt objekt prokurimi dhe sasia e tyre është si më poshtë:

1	2	3	4	5
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia e matjes	Sasia	Afati
1	Oriz	kg	90,000 (nëntëdhjetë mijë)	15 ditë
2	Vaj Ushqimor luledielli	litra	90,000 (nëntëdhjetë mijë)	15 ditë
3	Kripë	kg	30,000 (tridhjetë mijë)	15 ditë
4	Konserva Mish Viçi	kg	36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë)	15 ditë
5	Makarona	kg	90,000 (nëntëdhjetë mijë)	15 ditë
6	Fasule	kg	60,000 (gjashtëdhjetë mijë)	15 ditë
7	Sheqer	kg	60,000 (gjashtëdhjetë mijë)	15 ditë
8	Detergjent	kg	60,000 (gjashtëdhjetë mijë)	15 ditë
9	Sapun	copë	60,000 (gjashtëdhjetë mijë)	15 ditë

Shënim:

Në momentin e marrjes në dorëzim të artikujve ushqimorë, subjekti duhet të paraqesë fletë analizën/analizat për të gjithë treguesit e përcaktuar në këto specifikime teknike dhe certifikatën e origjinës së produkteve.

- Për Lotin nr. II, me objekt “*Blerje materiale mbrojtëse për mbështetjen e personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19*”, artikujt objekt prokurimi dhe sasia e tyre është si më poshtë:

1	2	3	4	5
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia e matjes	Sasia	Afati
1	Maska një përdorimëshe	copë	300,000 (treqind mijë)	15 ditë
2	Doreza mbrojtëse një përdorimëshe	palë	108,000 (njëqind e tetë mijë)	15 ditë
3	Dezifektues duarsh	litra	1,880	15 ditë

Dokumentet e tenderit - Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me objekt "Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19"

			(një mijë e tetëqind e tetëdhjetë)	
4	Kostume një përdorimëshe të mbrojtjes mjekësore	palë	1,000 (një mijë)	15 ditë
5	Pompa dezinfektuese	copë	61 (gjashtëdhjetë e një)	15 ditë
6	Klor i lëngët	kg	1,500 (një mijë e pesëqind)	15 ditë

Afatet e lëvrim: Duke filluar nga **lidhja e kontratës/ave** me përfundim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për secilin lot.

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimet Publike".

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Dokumentet e tenderit - Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me objekt “Blerje paketa ndihme për familjet në nevojë dhe materiale mbrojtëse në mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura të angazhuar në përballimin e emergjencës së shkaktuar nga rënia e pandemisë së virusit COVID - 19”

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 13

KUSHTET E PËRGJITHSHME

MALLRAT

PROCEDURA ME NEGOCIIM PA SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 "kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 "çmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 "Incoterms" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor.
